| 270 | VAKUFI XHAMIA DYLGJERHYSEN | | | 23 | ELBASAN | 8527 | 1426/1 | 721.5 | 12,764 | 9,209,226.0 |
| 271 | VAKUFI SHEH JAKUPIT | | | 24 | ELBASAN | 8527 | 1426/2 | 473.4 | 12,764 | 6,042,477.6 |
| 272 | ALI | XHEVDET | MIRAKU | 25 | ELBASAN | 8527 | 1426/3 | 856.8 | 12,764 | 10,936,195.2 |
| 273 | ISMAIL | XHEVDET | MIRAKU | | | | | | | |
| 274 | MEHMET | XHEVDET | MIRAKU | | | | | | | |
| 275 | PLATON | XHEVDET | MIRAKU | | | | | | | |
| 276 | RUKIJE | XHEVDET | MIRAKU | | | | | | | |
| 277 | ZYRA | XHEVDET | MIRAKU | | | | | | | |
| 278 | YMER | SALI | MULLAJONUZI | 26 | ELBASAN | 8527 | 1426/4 | 1094.4 | 12,764 | 13,968,921.6 |
| 279 | GJYLSYME | RRAHMI | BASHA | 27 | ELBASAN | 8527 | 1362/7 | 1129.3 | 12,764 | 14,414,385.2 |
| 280 | DALIP | KADRI | BAKALLI | 28 | ELBASAN | 8527 | 1362/5 | 110.4 | 12,764 | 1,409,145.6 |
| 281 | FATUSH | | BAKALLI | | | | | | | |
| 282 | NASHIFER | | BAKALLI | | | | | | | |
| 283 | MELEQ | | BAKALLI | | | | | | | |
| 284 | KADESHE | | BAKALLI | | | | | | | |
| 285 | MUSA | | BAKALLI | | | | | | | |
| 286 | SHEJNAZ | | BAKALLI | | | | | | | |
| 287 | BURBUQE | | BAKALLI | | | | | | | |
| 288 | DRITAN | SADIK | CENGELI | | | | | | | |
| | | | | | | | | **16.686,5** | **Shuma** | **211.422.214,4** |
| | | | | | **FIER** | | | | | |
| 289 | HARILLA | THEMI | MILE | 29 | FIER | 8534 | 1/270 | 830.1 | 12,893 | 10,702,479.3 |
| | | | | | | | | **830.1** | **Shuma** | 10,702,479.3 |
| | | | | | **SHKODËR** | | | | | |
| 290 | MYFTINIA | | | 30 | SHKODËR | 8597 | 13/133 | 120.5 | 8,511 | 1,025,575.5 |
| | | | | | | | | **120.5** | **Shuma** | 1,025,575.5 |
| | | | | | **TIRANË** | | | | | |
| 291 | AFRIM | | HOXHOLLI | 31 | TIRANË | 8230 | 4/378 | 334.4 | 23,703 | 7,926,283.2 |
| 292 | ARMANDO | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 293 | BUJAR | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 294 | ELFIDA | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 295 | ENVER | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 296 | FATBARDHA | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 297 | HAMIT | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 298 | LULJETA | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 299 | PETRIT | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 300 | QEMAL | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 301 | SABRI | | HOXHOLLI | | | | | | | |
| 302 | ILIR | | KALACI | 32 | TIRANË | 8190 | 8/334 | 83.0 | 33,755 | 2,801,665.0 |
| 303 | ZYBER | | BELBA | 33 | TIRANË | 8190 | 8/988 | 198.0 | 33,755 | 6,683,490.0 |
| 304 | SABRI | MAHMUT | HOXHA | 34 | TIRANË | 3993 | 1138 | 501.0 | 490 | 245,490.0 |
| 305 | BANKA EMPORIKI | | | 35 | TIRANË | 3550 | 56/2/1 | 300.0 | 457 | 137,100.0 |
| 306 | BANKA EMPORIKI | | | 36 | TIRANË | 3550 | 56/5 | 350.0 | 457 | 159,950.0 |
| 307 | BAKUSHE | OSMAN | ISUFI | 37 | TIRANË | 3550 | 56/4 | 225.0 | 457 | 102,825.0 |
| 308 | MONDI | RIFAT | LAMAJ | 38 | TIRANË | 2066 | 196/80 | 459.0 | 4,242 | 1,947,078.0 |
| | | | | | | | | **2,450.4** | **Shuma** | **20.003.881,2** |
| | | | | | **LEZHË** | | | | | |
| 308 | GJOK | DOD | DEDA | 39 | LEZHË | 8632 | 3/245 | 4.6 | 8,511 | 39,320.8 |
| 309 | GJOVALIN | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 310 | FRAN | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 311 | LENE | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 312 | DIELLE | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 313 | GJELINE | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 314 | MARE | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 315 | PRENE | DOD | DEDA | | | | | | | |
| 316 | LEZE | RROK | GJONI/NIKOLLAJ | 40 | LEZHË | 3126 | 4/18 | 300.0 | 3,435 | 1,030,500.0 |
| | | | | | | | | **304.6** | **Shuma** | **1.069.820,8** |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | **SIP. TOT.** | **20.392,1** | **SHUMA TOT.** | **244.223.971,3** |

**VENDIM**
**Nr. 679, datë 28.9.2016**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2016 PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/ 2015, "Për buxhetin e vitit 2016", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, në grupin shpenzime kapitale, si më poshtë vijon:

a) Programit buxhetor 09450, "Arsimi i lartë", t'i zbritet fondi prej 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekësh;

b) Programit buxhetor 09120, "Arsimi bazë", t'i shtohet fondi prej 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**VENDIM**
**Nr. 680, datë 28.9.2016**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TEK AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA), TË MJEDISEVE TË NDËRTESËS ME EMËRTIMIN "SHTËPIA E USHTARAKËVE", GJIROKASTËR, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 435, DATË 16.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", NË GJIROKASTËR , TË PRONËS NR. 600, ME EMËRTIMIN "SHTËPIA E USHTARAKËVE", GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit të parë të ndërtesës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", Gjirokastër, me sipërfaqe 412 (katërqind e dymbëdhjetë) $m^2$, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s.

2. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)

Fusha e perdorimit te Prones: Administrate

Identifikoi: **Matilda Qesja**
Pergjegjese e Sektorit Juridik, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Godinave, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)

Supervizoi: **Blerta Xhako**
Koordinator, Departamenti I Inovacionit dhe Mireqeverisjes, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Aprovoi: **Anis Lamllari**
Drejtor i Kabinetit, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 600 | | | | Shtëpia Ushtarakëve, Lagja "18 Shtatori", Gjirokastër | 412 m² | 412 m² | Administratë | Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) | Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) | Ndertese me 3 kate. Kati I pare I nderteses "Shtëpia Ushtarakëve", me siperfaqe pre 412 m² kalon në përgjegjësi administrimi te Agjencisë së Ofrimit të Shëbimeve Publike të Integruara. |

**VENDIM**
**Nr. 681, datë 28.9.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË–ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë – Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "arë", "kullotë", "truall", "drufrutorë" dhe "objekte", me vlerë të përgjithshme 23 611 897 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, nga të cilat:

- tokë "arë" dhe "kullotë", me sipërfaqe 43 151 $m^2$, me vlerë 19 356 532 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë;
- tokë "truall", me sipërfaqe 150 $m^2$, me vlerë 62 850 (gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë;
- "objekte", me sipërfaqe 198 $m^2$, me vlerë 3 278 943 (tre milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dyzet e tre) lekë;
- "drufrutorë", me vlerë 913 572 (nëntëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë "arë", "kullotë", "truall", "drufrutorë" dhe "objekte", prej 23 611 897 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri "Shpronësime", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", "Vërtetim hipotekor", "Certifikatë pronësie", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
**SEKTORI I SHPRONËSIMEVE**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
"TIRANË – ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË")

| Nr. | PRONARI | ZK | NR. PAS. | LLOJI I PASURISË | SIP. TOTALE | VLERËSIMET | | | Kultura bujqësore e drufrutorë | VLERA TOTALE (LEKË) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri i pronarit | | | | | SIP. ($m^2$) | ÇMIMI (LEKË/$m^2$) | Vlera (lekë) | | | |
| 1 | Zyhdi Idriz Shaba | 2704 | 538/23 | Arë | 3000 | 597 | 523 | 312231 | | 312231 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Bp. Zekthi etj | 2735 | 300/2 | Kullotë | 470 | 470 | 117 | 54990 | | 54990 | Certifikatë pronësie |
| 3 | Bashkepronaret Karamuca | 2735 | 22/5 | Arë | 4900 | 390 | 399 | 155610 | | 155610 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 4 | Altin Islam Sula | 2735 | 22/4 | Arë | 8600 | 248 | 399 | 98952 | | 98952 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 5 | Bashkim Ramiz Karamuca | 2735 | 22/6/8 | Arë | 7000 | 3358 | 399 | 1339842 | | 1339842 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 6 | Vjollca Dilaver Metani | 2735 | 113/18 | Arë | 3750 | 1742 | 399 | 695058 | | 695058 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 7 | B. Pronaret Metani | 2735 | 113/9 | Arë | 5000 | 2442 | 399 | 974358 | | 974358 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 8 | Zamir Rexhep Metani | 2735 | 127/3 | Arë | 2000 | 1301 | 399 | 519099 | | 519099 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 9 | Bashkepronaret Metani | 2735 | 113/11 | Arë | 2000 | 747 | 399 | 298053 | | 298053 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 10 | Syrja Dervishi | 2735 | 127/5 | Arë | 7700 | 815 | 399 | 325185 | | 325185 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 11 | Myslym Kerciku | 1622 | 23/27 | Arë | 1800 | 114 | 448 | 51072 | | 51072 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 12 | Bashkëpronarët Kerciku | 1622 | 23/46 | Arë | 290 | 64 | 448 | 28672 | | 28672 | Certifikatë pronësie |
| 13 | Gezim Shefqet Sallaku | 1498 | 426/20/1 | Arë | 2430 | 2035 | | | 335544 | 335544 | Certifikatë pronësie |
| 14 | Shefqet Sallaku | 1498 | 426/2 | Arë | 900 | 900 | | | 109650 | 109650 | Certifikatë pronësie |
| 15 | Bashkëpronarët Ahmetaj | 1170 | 122/2 | Arë | 1000 | 1000 | | | 163242 | 163242 | Certifikatë pronësie |
| 16 | Albert Ndue Skana | 1977 | 44/72 | Arë | 7900 | 7900 | 470 | 3713000 | | 3713000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 17 | Rexhep Gjuzi | 1977 | 41/5 | Arë | 22700 | 7663 | 470 | 3601610 | | 3601610 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 18 | Sinan Sherifi | 1977 | 44/69 | Arë | 1500 | 1500 | 470 | 705000 | | 705000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 19 | Bashkëpronarët Sherifi | 1977 | 44/67 | Arë | 1200 | 1200 | 470 | 564000 | | 564000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 20 | Laert Duro &Shansi Invest Shpk | 1977 | 44/58 | Arë | 14000 | 10500 | 470 | 4935000 | | 4935000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 21 | Laert Duro &Shansi Invest Shpk | 1977 | 44/39 | Arë | 6000 | 1738 | 470 | 816860 | | 816860 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 22 | Bashkëpronarët Çoku | 1977 | 301/11 | Arë | 3100 | 262 | 470 | 123140 | | 123140 | Certifikatë pronësie |
| 23 | Fatmir Ibrahim Velija | 2752 | 22/1 | Ullishte | 650 | 650 | | | 305136 | 305136 | Certifikatë pronësie |
| 24 | Zyber Tarja | 2752 | 57/2 | Arë | 100 | 100 | 448 | 44800 | | 44800 | Certifikatë pronësie |
| | **TOTALI** | | | | | | | **19356532** | **913572** | **20270104** | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
**SEKTORI I SHPRONËSIMEVE**

LISTA E PRONAVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"TIRANË–ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË)"

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Z. Kadast. | Nr. pas. | Lloji i pas. | Sip. total | Sip. ndërt. $m^2$ | Vlera (lekë) | Lloji pas. | Sip. truall $m^2$ | Çmimi (lekë /$m^2$) | Vlera (lekë) | Vlera totale | Konfirmime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shefikat | Dalip | Filolli | 1977 | 306/1 | NDËRTESË | 50 | 50 | 693758 | TRUALL | 50 | 419 | 20950 | 714708 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Shefikat | Dalip | Filolli | 1977 | 306/3 | NDËRTESË | 100 | 100 | 2E+06 | TRUALL | 100 | 419 | 41900 | 1936539 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 3 | Xhelal | | Filolli | 1977 | 306/2 | NDËRTESË | 48 | 48 | 690546 | | | | | 690546 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| **TOTALI** | | | | | | | 198 | 198 | 32.789.43 | | 150 | | 62850 | **33.417.93** | |

**VENDIM**
**Nr. 682, datë 28.9.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY-PASS VLORË (OBJEKTE)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Vlorë (objekte)".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "objekte", në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 28 693 975 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë "objekte", prej 28 693 975 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri "Shpronësime", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", "Vërtetim hipotekor", "Certifikatë pronësie", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.
9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
**SEKTORI SHPRONËSIMEVE**

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË (objekte)"

| Nr | PRONARI | | | Z. K. | Nr. i pasurisë | Sipërfaqe ndërtimi | | | | | Vlefta totale në lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | Sip. ndërtimi $m^2$ | Lloji i ndërtimit | Sipërfaqe ndërtimi Vlefta lekë /$m^2$ | Vlefta Sipërfaqe ndërtimi | Vlefta në lekë Bodrumi | | |
| 1 | SMAIL | AVNI | LALAJ | 8605 | 6/146 | 120 | objekt banimi | 60120 | 7214400 | 2E+06 | 8787702 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 2 | PETRIT | | HODAJ | 1060 | 320 | 785 | objekt biznesi | | 10433340 | | 10433340 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 3 | BESIM | | LAMAJ | 2074 | 1019 | 49.6 | objekt banimi | | 532131 | | 532131 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 4 | BESIM | | LAMAJ | 2074 | 1019/2 | 81 | objekt banimi | | 1377245 | | 1377245 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 5 | BESIM | | LAMAJ | 3140 | zonë e pamen axhuar | 38 | objekt biznesi | | 997837 | | 997837 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 6 | SADETE | VEHBI | SKENDAJ | 3140 | zonë e pamen axhuar | 58 | objekt banimi | | 1515640 | | 1515640 | Akt-marrëveshja ligj. nr. 8/2012, datë 9.2.2012 |
| 7 | ARBEN | RESUL | HAZIZAJ | 8605 | 6/273 | 84 | objekt banimi | 60120 | 5050080 | | 5050080 | |
| | **SHUMA** | | | | | | | | | | **28693975** | |

## VENDIM
## Nr. 683, datë 28.9.2016

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ANSAMBLI I RILINDJES URBANE, BELSH"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ansambli i Rilindjes Urbane, Belsh".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Belsh.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall", "objekt shërbimi" dhe "objekt banimi", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 1 696 098 (pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 51 696 098 (pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet, përkatësisht, 36 696 098 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë, dhe 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Bashkisë Belsh.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Belsh.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Belsh, të fillojë

procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Belsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE E PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN: "ANSAMBLI I RILINDJES URBANE BELSH", BASHKIA BELSH**
**1. OBJEKTET QË JANË NË KURORËN E LIQENIT TË BELSHIT ME CERTIFIKATË PRONËSIE** (Për objektet e banimit, shërbimit dhe truallin)

| Nr. | Emër, atësia, mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sipërfaqja e objektit të banimit (m²) | Sipërfaqja e truallit (m²) | Sipërfaqja e objektit të shërbimit (m²) | Çmimi i objektit të banimit (lekë/m²) | Çmimi truall (lekë/m²) | Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë) | Vlera e objektit të banimit (lekë) | VLERA E AMORTIZIMI PËR NDËRTESAT (Koha e vënies në funksion 20-vjet/1% në vit) | Vlera e truallit (lekë) | Vlera totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lekë) | Dokumenti i pronësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 1 | CAUSH ISLAM TAFANI | 1147 | 30/36 | 0 | 196.6 | 125.5 | 32,335.00 | 234 | 1681290.72 | 0 | 0 | 46004.4 | 1727295.12 | Certifikatë pronësie |
| 2 | BASHKEPRONARE, JORGO QAMIL KUQJA, ANA BASHKIM KUQJA | 1147 | 30/37/2 | | 49.88 | 36.98 | 32,335.00 | 234 | 643,766.88 | - | - | 11,671.92 | 655,438.80 | Certifikatë pronësie |
| 3 | LAVDIJE ALI SENIA | 1147 | 30/10/2 | | | 20.00 | 32,335.00 | 234 | 498,757.25 | - | - | - | 498,757.25 | Certifikatë pronësie |
| 4 | LAVDIJE ALI SENIA | 1147 | 30/31 | | 166.00 | 70.00 | 32,335.00 | 234 | 1,143,314.40 | - | - | 38,844.00 | 1,182,158.40 | Certifikatë pronësie |
| 5 | ZYBER HALIT KUQJA | 1147 | 30/37/1 | | 146.02 | 122.12 | 32,335.00 | 234 | 1,735,323.84 | - | - | 34,168.68 | 1,769,492.52 | Certifikatë pronësie |
| 6 | FASLLI KARAFIL PIRE | 1147 | 30/38 | | 49.2 | 49.2 | 32,335.00 | 234 | 1,374,784.80 | 0 | 0 | 11,512.80 | 1,386,297.60 | Certifikatë pronësie |
| 7 | NADIRE HAJDAR ALLANI | 1147 | 275/50 | | 61.40 | 35.30 | 32,335.00 | 234 | 891,012.00 | - | - | 14,367.60 | 905,379.60 | Certifikatë pronësie |
| 8 | BUJAR HYDAJET URUÇI | 1147 | 30/6 | 216.00 | | 216.00 | 32,335.00 | 234 | 2,847,347.52 | 6,984,360.00 | ######### | - | 8,434,835.52 | Certifikatë pronësie |
| 9 | ADEM JONUZ MUÇA | 1147 | 30/39 | | 416.00 | 305.40 | 32,335.00 | 234 | 3,543,537.60 | - | - | 97,344.00 | 3,640,881.60 | Certifikatë pronësie |
| 10 | PETRIT ZYLYF LIÇI | 1147 | 30/78/1 (30/28) | | 50.00 | 50.00 | 32,335.00 | 234 | 1,028,336.16 | - | - | 11,700.00 | 1,040,036.16 | Certifikatë pronësie |
| 11 | BULE AXHEM TAFANI | 1147 | 30/20 | | | 25.08 | 32,335.00 | 234 | 539,140.32 | - | - | - | 539,140.32 | Certifikatë pronësie |
| 12 | ARISTIDHIS MESUT GJOLENA | 1147 | 30/21 | | | 25.08 | 32,335.00 | 234 | 492,395.52 | - | - | - | 492,395.52 | Certifikatë pronësie |
| 13 | HAJRIE MYSLIM HYSA | 1147 | 30/25 | | | 48.64 | 32,335.00 | 234 | 887,339.04 | - | - | - | 887,339.04 | Certifikatë pronësie |
| 14 | BASHKEPRONARE, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI | 1147 | 30/56 | | 56.93 | | 32,335.00 | 234 | | - | - | 13,321.62 | 13,321.62 | Certifikatë pronësie |
| 15 | BASHKEPRONARE, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI | 1147 | 30/22-ND | | | 25.08 | 32,335.00 | 234 | 427,412.16 | | | - | 427,412.16 | |
| 16 | BASHKEPRONARE, SHABAN SHEFIT KASA, KAFAZE RUSTEM KASA, ASLLAN GANI PEQINI, BURBUQE YZEIR PEQINI | 1147 | 30/23 | | | 25.84 | 32,335.00 | 234 | 492,236.16 | - | - | - | 492,236.16 | Certifikatë pronësie |
| 17 | SHABAN SHEFIT KASA | 1147 | 30/24 | | 63.13 | 30.18 | 32,335.00 | 234 | 596,321.28 | - | - | 14,772.42 | 611,093.70 | Certifikatë pronësie |
| 18 | ZEQO ILIAZ SULA | 1147 | 30/5 | | 156.00 | 96.00 | 32,335.00 | 234 | 1,673,849.76 | - | - | 36,504.00 | 1,710,353.76 | Certifikatë pronësie |
| 19 | ZABIT ZIHNI IDRIZI | 1147 | 30/2-N2 (30/17) | | 116.00 | 68.80 | 32,335.00 | 234 | 1,042,347.36 | - | - | 27,144.00 | 1,069,491.36 | Certifikatë pronësie |
| 20 | BASHKEPRONARE, TAULAND SHEFQET HYSA, ILIR SHEFQET HYSA | 1147 | 30/44 | | 52.80 | 52.80 | 32,335.00 | 234 | 964,312.80 | - | - | 12,355.20 | 976,668.00 | Certifikatë pronësie |
| 21 | JORGO ZANI DUNGA | 1147 | 30/43 | | 251.8 | 251.8 | 32,335.00 | 234 | 2,585,273.28 | 0 | 0 | 58,921.20 | 2644194.48 | Certifikatë pronësie |
| 22 | ARDIAN MESUT HYSA | 1147 | 30/40 | | 186.70 | 146.90 | 32,335.00 | 234 | 2,278,725.12 | - | - | 43,687.80 | 2,322,412.92 | Certifikatë pronësie |
| 23 | BUJAR DERVISH KUQJA | 1147 | 30/13 | | | 38.64 | 32,335.00 | 234 | 589,158.24 | - | - | - | 589,158.24 | Certifikatë pronësie |
| 24 | BUJAR DERVISH KUQJA | 1147 | 30/12 | | | 32.96 | 32,335.00 | 234 | 564,283.20 | - | - | - | 564,283.20 | Certifikatë pronësie |
| 25 | BUJAR DERVISH KUQJA | 1147 | 30/11 | | | 21.60 | 32,335.00 | 234 | 657,766.08 | - | - | - | 657,766.08 | Certifikatë pronësie |
| 26 | BUJAR DERVISH KUQJA | 1147 | 30/10 | | | 68.80 | 32,335.00 | 234 | 1,101,029.28 | - | - | - | 1,101,029.28 | Certifikatë pronësie |
| **TOTALI** | | | | | | | **32,335.00** | **234** | **30,279,060.77** | **6,984,360.00** | **(1,396,872.00)** | **472,319.64** | **36,338,868.41** | |

**VENDIM**
**Nr. 684, datë 28.9.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM ASFALTIM RRUGË E SHESHE, BLLOQET E BANIMIT SHEJA, TREGU I QYTETIT, SHKUMBINI DHE USHTARAKU", LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Sistemim asfaltim rrugë e sheshe, blloqet e banimit Sheja, tregu i qytetit, Shkumbini dhe Ushtaraku", Librazhd.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Librazhd.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme 370 690 (treqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 370 690 (treqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Librazhd.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Librazhd.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Librazhd, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd dhe Bashkia Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

BASHKIA LIBRAZHD
LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
"SISTEMIM ASFALTIM RRUGË E SHESHE, BLLOQET E BANIMIT SHEJA, TREGU I QYTETIT, SHKUMBINI DHE USHTARAKU", LIBRAZHD

| Nr. | Pronari | ZK | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqe truall $m^2$ | Çmimi i truallit leke/$m^2$ | Vlera e truallit | Vlera e objektit lekë | Vlera totale e shpronësimit lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tahir Destan Bahiti | 2446 | 10/209 | Truall | 48 | 2,898 | 139,104 | 231,586 | 370,690 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |

**VENDIM**
**Nr. 698, datë 5.10.2016**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. THIMIO PLAKU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Thimio Plaku, në masën 3 800 000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**URDHËR**
**Nr. 6485, datë 30.9.2016**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e titullarit Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 1.10.2016 deri në datën 7.10.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.
2. Ngarkohet zëvendësministri z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
**Ylli Manjani**

**KËRKESË**

Shtetasit Kadri Toçilla, i biri i Jahit dhe i Xhemiles, i datëlindjes së vitit 1968, lindur në Novosejë, Kukës dhe banues në Tiranë, dhe Florije Toçilla, e bija e Qemalit dhe e Shkurtes, e datëlindjes së vitit 1980, lindur në Kukës dhe banuese në Tiranë, kërkojnë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të së bijës, shtetases Klodjana Toçilla, e datëlindjes 25.2.1999.

KËRKUES
**Kadri Toçilla**
**Florije Toçilla**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës“Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë